



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ÇËRRIK

Nr. _____ Prot.

Cërrik, më 20.01.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: /Gega Center GKG Tirane , Njesia nr 1. Rruga "Ali Demi " /

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-46581-12-19-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Blerje gazoil (10ppm) per mjetet e Bashkise per vitin 2020"**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [23.12.2019] [51]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **GEGA CENTER GKG** me Nr.Nipt **K66801001T** me oferte me vlere, me marzh fitimi **7.7%** (shtate presje shtate perqind).
2. Operatori Ekonomik **A-ELEZI PETROL 1** Sh.p.k me Nr.Nipt **L23011201C** me oferte me vlere, me marzh fitimi **9.8%** (nente presje tete perqind).
3. Operatori Ekonomik **KASTRATI** Sh.p.k me Nr.Nipt **J61813529P** me oferte me vlere, me marzh fitimi **7.4%** (shtate presje katër perqind).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik **A-ELEZI PETROL 1** Sh.p.k me Nr.Nipt **L23011201C** me oferte me vlere, me marzh fitimi **9.8%** (nente presje tete perqind).

Autoriteti kontraktor per : **2. kriteret e veçanta të kualifikimit**

dh.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Per sa me siper operatori ekonomik vertetimin e OSHEE eshte jashte afatit per shkak se duhet te paraqiste pagesen e detyrimeve per muajin nentor,dhe komisioni i vleresimit te ofertave vendos skualifikimin e operatorit.

2. Operatori Ekonomik **KASTRATI** Sh.p.k me Nr.Nipt **J61813529P** me oferte me vlere, me marzh fitimi **7.4%** (shtate presje katër perqind).

Autoriteti Kontraktor per: **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 per cdo vend te ushtrimit te aktivitetit sipas QKB

Operatori ekonomik:

1. **Kastrati nuk ka arritur te paraqese dokumentacion qe verteton se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per periudhen nga 2019 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006. "Per taksat vendore"**

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri per kualifikim, operatori kastrati ka paraqitur vertetime per pagesn e detyrimeve vendore ne disa NJQV ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet ne periudhen e kerkuar ne DT por nga ekstrakti i QKB, qe ka dorezuar ne prokurim rezulton se Kastrati ka ushtruar aktivitetet gjate vitit 2019 edhe ne Njesite e Qeverisjes Vendore:

1. Gramsh
2. Pogradec
3. Rrogozhine
4. Mirdite (dokumenti i paraqitur nuk eshte firmosur nga titullari dhe mungon vula e institucionit.

Njesi vendore nga te cilat nuk ka paraqitur dokumentacion qe verteton se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006. "Per taksat vendore "

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të

kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Në nenin 11, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...]Detyrimi i taksës për t’u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe reregjistrimit të tij[...].” Operatori ekonomik Kastrati sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht, ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin e tij sipas ekstraktit të QKR-së si edhe për periudhën e kërkuar sipas përcaktimit të bërë në dokumentat e tenderit, duke mos përmbushur kriterin për kualifikim. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Pra persa me lart konstatohet se operatori ekonomik Kastrati sh.p.k. nuk ka plotësuar kriterin e mesiperm dhe komisioni i vlerësimit të ofertave ka vendosur shkualifikimin e operatorit të mesiperm

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Gega Center GKG Tirane , Njesia nr 1. Rruga "Ali Demi "** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7.7 % është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Cërrik, Lagja Nr.2 Ruga "Gjimnazistet 1962"* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar “_____”, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [_____], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10.01.2020**

Ankesa: **s’ka**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
K R Y E T A R I
Andis SALLA